

Si mundemi ne të ndihmojmë individët gjatë COVID-19



Përdorni linjën tonë të ndihmës në WhatsApp

Ju mund të na dergoni mesazhe nëse keni ndonjë pyetje rreth aplikimit

Cfarë është Skema e Qendrimit të Bashkimit Europian (BE-së)?

A jeni një shtetas i ndonjë shteti të BE-së ose anëtar familjar i një shtetasi të BE-së që jeton në Mbretërinë e Bashkuar?

Ju duhet të aplikoni për Skemën e Qendrimit të Bashkimit Europian përpara datës 30 Qershor 2021 për të marrë status të ri të emigrimit.

Statusi i ri i emigracionit mbron të drejtat e juaja për të vazhduar të jetoni në Mbretërinë e Bashkuar.

Ju do të keni nevojë për të aplikuar për status të ri të emigracionit përmes Skemes së Qendrimit në mënyrë që ju të keni qasje në ndihma sociale, për të marrë me qera një pronë, për të aplikuar për ndonjë punë, për të pasur qasje në sistemin shëndetësor.

Procesi i aplikimit për Skemën e Qendrimit të BE-së është dixhital dhe statusi që merrni është gjithashtu plotësisht dixhital.

Si mund të aplikoni?

Aplikimi për Skemën e Qendrimit të Bashkimit Europian është falas.

Aplikimi bëhet përmes një aplikacioni që ju duhet të shkarkoni në telefonin tuaj, proces që bëhet online dhe me internet, në të cilin ju duhet të vertetoni qendrimin tuaj në Mbretërinë e Bashkuar.

Ministria e Brendshme (Home Office) do të kontrollojë aplikimin tuaj dhe ju jep ju ose statusi të përkohshëm për qendrim (nëse keni jetuar në Mbretërinë e Bashkuar për më pak se 5 vite) ose statusi të përhershëm për qendrim (nëse keni jetuar në Mbretërinë e Bashkuar për më shumë se 5 vite).

Aplikimi për Skemën e Qendrimit të Bashkimit Europian duhet të bëhet para datës 30 Qershor 2021

Si mundemi ne të ju ndihmojmë?

- ✓ Ne ofrojmë mbështetje dhe këshilla falas për njerëzit që aplikojnë për Skemën e Qendrimit të Bashkimit Europian.
- ✓ Ne kemi shumë informacione në gjuhë të ndryshme që mund të ju ndihmojë ju për të bërë aplikimin tuaj.
- ✓ Ne gjithashtu mund t'ju ndihmojmë të mësoni se si të menaxhoni statusin tuaj të emigracionit dixhital – si të rifreskoni detajet tuaja, të ndani statusin tuaj me njerëz të tjerë.

Ose na shkruani email në help@newEuropeans.net

